

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE, Gjyqtari Ragip Kadriu ne qeshtjen
juridike te paditesit; nga Mitrovica te cilin e perfaqson Avokat ne
Mitrovice; kunder te paditures; te cilin e perfaqson
e kontestit; kompenzimin e te ardhurave personale, vlere e lendes
se kontestit; 12.571,72 Euro, pase mbajtjes se shqyrtimit kryesor te dt.03.11.2015, bie kete.

AKT GJYKIM

APROVOHET kerkespadia e paditesit; nga Mitrovica dhe
OBLIGOHET e paditura; qe ne emer te pagave mujore nga -kontrata
mbi vepren ti paguaj paditesit per periudhen kohore nga dt.[01.09.2011 e gjer me 24.12.2013],
shumen prej 12.571,72 Euro, me kamat vjetore 3,5%, duke filluar nga dt. gjykimit e gjer ne
pagesen definitive e te gjitha keto ne afatin prej 15 diteve nga dita e pranimit te ketije
aktgjykimi.

Obligohet e paditura qe paditesit te ia kompenzoi shpenzimet e procedures
kontestimore ne shume prej 460,96 Euro, ne afatin prej 15 diteve, nga dita e pranimit te ketije
aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditesi ne padin e parashtuar, precizimin e saj si dhe ne seancat e mbajtura ka theksuar;
Kryetarit te Komunes Nr. 03.08.2010 eshte emruar Kshilltar per Siguri
Kryetarit. Sipas ketij vendimi paditesi ka pas per detyre te kshillon dhe ndihmon
Kryetarin ne ushtrimin e funksioneve te perditeshme per te gjitha qeshtjet qe kane te bejne me
sigurin ne Komunen e Mitrovices. Per pergjegjsit e parapara sipas ketij vendimi paditesi per
punen e tij eshte parapar kompenzimi me page mujore duke filluar nga Shtatori i vit 2011 nga
60 Euro, sipas kontrates mbi vepren ne kohzgjatje e lidhur me mandatin e Kryetarit te
Komunes se Mitrovices.

E paditura refuzon ti paguaj te ardhurat personale me motivacion se nuk kane para ne
buxhet.

I autorizuari i paditesit ne seancen e shqyrtimit kryesor ne fjalen perfundimtare i propozoi
gjykates qe padin dhe percizimin e kerkespadise ta aprovoi si te bazuar.

Shpenzimet e procedures kontestimore i kerkoj.



Perfaqsesi i te paditures e kundershtoi padine dhe precizimin e kerkespadis si te pabazuar si dhe parashtroje prapsimin e parashkrimit.

Shpenzimet nuk i kerkoi.

Gjykata ne seancen e shqyrtimit kryesor zhvilloi provat e nevojshme dhe pas administrimit dhe vlersimit te te njejtave ne kuptim te nen. 8 te LPK, erdhi ne perfundim se duhet vendosur si ne dispozitive te ketije aktgjykimi.

Gjykata ne proceduren e provave lexoi; Vendimin e te paditures, Nr. dt
03.08.2010, Kontraten mbi vepren dt. 03.08.2010, Dekleraten solemne Nr, dt.
24.12.2013, Pasqyren financiare nga e paditura dhe konstatoi kete gjendje faktike;

Nga vendimi i te paditures i sipercekur vertetohet; se me vendimin e Kryetarit te Komunes paditesi eshte emruar siguri prane me kohzgjatje e lidhur me e duke filluar nga dt.03.08.2010.

Nga Kontrata e mbi vepren e cekur me larte konstatohet se Paditesi me te padituren kane lidhur Kontra tmbi vepren per nevojat e ; te ofroje sherbime profesionale ne lidhje me qeshtjen e sigurise, me kohzgjatje e lidhur me mandatin e Kryetarit duke filluar nga dt 03.08.2010 e tutje ku eshte parpar edhe kompenzimi i pages mujore , sipas koeficientit 9.


Nga Deklerata Solemne e sipercekur, vertetohet se me dt 24.12.2013, tani aktual i te paditures ka dhen betimin per Kryetar.

Nga Pasqyra financiare e te paditures , vertetohet se paga mujore e paditesit duke filluar nga Qershori i vit. 2011 ka qene ne lartsi prej 448.99 Euro, te cilen paditesi e ka realizuar gjer ne Gusht 2011.

Ne nje gjendje te ketille faktike -nga provat e cekura me larte , rrjedhe se; Kontrata mbi vepren eshte e lidhur ne formen dhe permbajtjen e parapar ne kuptim te nen. 10 dhe 11. te Ligjit i punes [Ligji Nr.03/2-212].

Konform nen 55 pika 1 dhe 6 te Ligjit te punes eshte percaktuar; I punesuari ka te drejt ne page e cila percaktohet me kontraten e punes, ne pajtim me ket ligj, Kontraten kolektive, Aktin e brendshem te punedhenesit dhe se paga paguhet me se paku 1 her ne muaj.

Ne rastin konkret kemi te bejme me Kontrat mbi vepren te kontraktuar dhe percaktuar ne afat prej 03.08.2010 ne kohzgjatje e lidhur me mandatin e Kryetarit te Komunes se Mitrovices ku lende e kontrates eshte puna- kryrja e punes se caktuar, pra kemi nje marrdhenje-juridike midis paditesit dhe te paditures me te cilen paditesi eshte i obliguar qe ta kryeje punen e caktuar siq eshte caktuar ne kontraten mbi vepren te cekur me larte, kurse e paditura detyrohet qe per kete paditesit, ti paguaj shperblimin e caktuar e ter kjo konform nen. 600 te Ligjit mbi marrdhenjet detyrimore. [vjeter] i aplikuar, konform nen 1057 te Ligjit per Marrdhenjet e Detyrimeve Ligji Nr. 04/L-077].



Ne mes ndegjyqesve nuk u parashtruan prapesime lidhur me ate se paditesi ka punuar ne periudhen per te cilen kerkon pageses e pagave dhe se e padituar gjernetani nuk i ka ber kete pagese paditesit.

Gjykata me shkres i eshte drejtuar te paditures lidhur me te dhenat , provat dhe informacionet lidhur me periudhen e kohes se punes te paditesit pran te paditures, lartsin e pages per periudhen tani lendore, mirepo e njejta nuk ka afruar kurfar informacioni lidhur me kete kerkese te gjykates.

Prandaj duke u nisur nga provat materiale te sipercekura, gjykata konkludon se paditesi ka punuar ne periudhen kontestuese, nga 03.08.2010 e gjer 30.12.2012, ku te njejtit gjer ne Gusht 2011 i jane kompenzuar pagat mujore, ndrsa nga Shtatori i vit 2011 gjer 30.12.2012, nuk i jane paguar te ardhurat personale mujore nga 448,99 euro, [gjithsejt 28 muaj x 448.99 Euro= 12.571,72 Euro], prandaj vendosi si ne dispozitiv te ketije aktgjykimi.

Gjithashtu gjykata vlerson te pabazuar prapsimin e te paditures lidhur me parashkrimin e kerkeses se paditesit, nga se konform nen 67 te Ligjit te punes eshte percaktuar; afati prej 3-viteve nga dt. e paraqitjes se kerkeses, qka ne rasti konkret nuk kemi parshkrim te kerkeses sepse nga vula e pranimit te gjykates vertetohet se paditesi ka ngritur padi me 28.10.2014.

Vendimi mbi kamaten bazohet ne dispoziten e nen.378 te LMD. duke filluar nga dt. gjykimit kur paditesi beri edhe precizimin e kerkespadise .

Vendimi mbi shpenzimet e procedures kontestimore, bazohet konform nen, 452.1 dhe 453.2 te LPK, duke i njohur paditesit shpenzimet dhe at; per perpilimin e padise, shumen prej 93,00 Euro, per pjesmarrje ne 2- seanca te autorizuarit te tije, shumen per nga 121,68 Euro ,, konform nr. Tarifor 6 e 7 te TA, si dhe ne emer te taksave per padi dhe aktgjykim, shume prej 124,00 euro, konform nen.10.1 Tarifes mbi taksat gjyqsore .

Nga si u tha me larte u vendose si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE

C. nr. 713/2014 dt. 03.11.2015



KESHILLE JURIDIKE, Kunder ketije aktgjykimi munde te ushtrohet ankese ne afatin prej 15 diteve , nga dita e pranimit Gjykates se Apelit te Kosoves e nepermjet te kesaje gjykate.